

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË E RAJONIT QENDROR TIRANË
(AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR)

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë (Autoriteti Rrugor Shqiptar)**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 178, datë 23.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 741/10, datë 23.12.2014, i ka rekomanduar z. Bib Gjomarkaj, Drejtor i Rajonit Qendror Tiranë (Autoriteti Rrugor Shqiptar), zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nuk është hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar rregullorja e brendshme për funksionimin e kësaj Drejtorie. Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë ka hartuar një rregullore të brendshme, e cila është miratuar nga Drejtori me urdhrin nr. 51/1, datë 05.10.2012, kjo rregullore deri në momentin e auditimit nuk është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH edhe pse në zbatim të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009 “*Për Autoritetin Rrugor Shqiptar*”, ky institucion është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit, për Drejtoritë Rajonale.

Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të hartojë dhe miratojë Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të kësaj Drejtorie.

Brenda datës 31.01.2015

2. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha dosjet e personelit nuk janë plotësuar dhe përditësuar me certifikatat e *gjendjes gjyqësore* dhe *Raportin mjeko ligjor* të çdo punonjësi, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009 “*Për Autoritetin Rrugor Shqiptar*”.

Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që të plotësohen dhe të përditësohen të gjitha dosjet e personelit, me certifikatat e *gjendjes gjyqësore* dhe *Raportin mjeko ligjor* për çdo punonjës.

Brenda datës 31.01.2015

3. Gjetje nga auditimi: Në dy raste janë kryer pagesa në vlerën **979,300 lekë**, për shlyerjen e detyrimeve gjyqësore ndaj sipërmarrësve privat, për këto vendime nuk është bërë rekurs në gjykatat respektive, veprime këto në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile” dhe me Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*”.

Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që për këto dy raste, të kërkojë të rivendosë në afat e të ndjekë procedurat ligjore , ndërsa për shprehjet e vendimeve të gjykatës jo në favor të institucionit, të bëhet rekurs duke ndjekur të tre shkallët e gjykimit, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile dhe Udhëzimin e MF “*Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*”.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për **8 raste** që janë realizuar blerje me vlera të vogla gjatë vitit 2012, në vlerën **832,118 lekë**, ka rezultuar se urdhrat e prokurimit nuk janë plotësuar me ekstremitetet e nevojshme si sasi, çmim dhe vlerë për mallra, shërbime apo punë, gjithashtu edhe procesverbalet e mbajtura nga komisioni i blerjeve te vogla, nuk janë plotësuar me

artikujt dhe sasi të e kërkuara dhe në **dy raste** u konstatua se janë kryer prokurime me vlera të vogla, pa urdhër prokurimi të lëshuar nga titullari i institucionit.

Për **7 raste** që janë realizuar blerje me vlera të vogla gjatë vitit 2013, në vlerën **1,132,869 lekë** dhe për **4 raste** gjatë periudhës Janar-Korrik 2014, në vlerën **928,261 lekë**, u konstatua se nuk është mbajtur procesverbal për llogaritjen dhe argumentimin e vlerës së fondit limit dhe në dosje nuk janë kërkesat nga sektorët përkatës për blerje, mallra, punë apo shërbime, sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2, të kreut VI, të VKM nr. 1, datë 14.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që për të gjitha rastet, blerjet me vlera të vogla të kryhen në bazë të nevojave mbështetur në kërkesat e sektorëve përkatës. Për të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla, titullari i institucionit duhet të nxjerr Urdhrat e prokurimit, të cilët duhet të plotësohen me ekstremitetet e nevojshme si sasi, çmim e vlerë dhe të mbahen procesverbalet përkatëse për llogaritjen dhe argumentimin e fondit limit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: DRQ Tiranë nuk disponon dosje të veçantë për çdo aks rrugor, e cila duhet të përmbajë projektin e zbatimit, inventarin e rrugës të përditësuar, duke përfshirë të gjitha detajet: parametrat e rrugëve, nivelin e shtresave dhe nënshtresave, gjatësitë e kanaleve, tobinove, urave, trafik ndarëseve, mureve mbajtës apo pritës dhe çdo detaj tjetër të rrugës.

Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që për çdo aks rrugor që ka në administrim e inventar, të mbahen dosje të veçanta, të cilat duhet të përmbajnë: projektin e zbatimit dhe inventarin e rrugës të përditësuar, duke përfshirë të gjitha detajet dhe parametrat e rrugëve.

Brenda datës 31.01.2015

6. Gjetje nga auditimi: Nuk është mbajtur inventari i përditësuar i akseve rrugore dhe nuk është nxjerrë niveli i amortizimit të rrugëve, mbështetur në manualet dhe normat teknike të amortizimit të rrugëve. Nga të dhënat e pasqyrave financiare të vitit 2012, rezulton se nuk është llogaritur amortizimi i rrugëve, ndërsa për vitin 2013 llogaritja është bërë e paargumentuar dhe pa u bazuar në normat teknike të amortizimit të rrjeteve rrugore, mbështetur në këto të dhëna duhet të planifikohen dhe llogariten vlerat e kontratave për mirëmbajtjen e rrugëve.

Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që për çdo aks rrugor të kryhen rillogaritje të amortizimit dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme në kontabilitet, të mbahen evidenca kontabël për nivelin e amortizimit (konsumimit të shtresës asfaltimit), amortizimin e akumuluar dhe llogaritja e vlerave të kontratave të mirëmbajtjes të bëhet duke marrë në konsideratë amortizimin, konsumimin e rrugëve dhe të mbështeten në inventarin e rrugëve.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Inventari i ndërtesave që administrojnë DRQ Tiranë, është mbajtur në terma shumë të përgjithshëm, nuk ka asnjë të dhënë lidhur me parametrat fizik të ndërtesave, nuk disponohen Gent planet dhe certifikatat e pronësisë.

Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që të plotësohet inventari i ndërtesave me të dhënat përkatëse të parametrave fizik të ndërtesave dhe të plotësohet me Gent-plane përkatëse dhe të gjenden rrugët ligjore për regjistrimin e tyre në ZVRPP-në Tiranë e rrethe.

Brenda datës 31.05.2015

8. Gjetje nga auditimi: Nuk janë ndjekur procedurat ligjore dhe nuk është bërë administrimi faktik në inventarin e kësaj drejtorie për disa objekte, të cilat janë zënë nga të tretë para shumë vitesh dhe një fabrikë Asfalto- Betoni me vendndodhje në Golem të Durrësit, e cila ka qenë për vite me radhë tërësisht jashtë funksioni.

8.1. Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që të ndiqen rrugët ligjore për lirimin e objekteve dhe administrimin e tyre sipas kërkesave ligjore dhe largimin e banorëve që kanë zënë këto ndërtesa.

Menjëherë

8.2. Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që të ndiqen procedurat ligjore për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, asgjësimin dhe zbritjen nga kontabiliteti, të vlerës së Fabrikës së Asfalto- Betonit me vendndodhje në Golem të Durrësit.

Brenda datës 28.02.2015

8.3. Rekomandimi: DRQ Tiranë të marrë masa që të ngrihet grup pune me specialistë, të cilët të vlerësojnë gjendjen e objekteve dhe të promovojnë hapat e tjerë ligjorë për sistemimin e tyre.

Brenda datës 28.02.2015

9. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2013 janë në inventar gjendje makineri teknike dhe mjete transporti në vlerën **261,403,995 lekë**, ku rezulton se shumica e tyre nuk janë të pajisur dhe nuk kanë dokumentacion teknik dhe kartela shfrytëzimi, në të cilat të jenë përshkruar orët e punës, volumet e kryera dhe kilometrat e përshkuara deri në momentin e dorëzimit, për çdo mjet dhe makineri.

-Një pjesë e mirë e automjeteve, mjetet teknologjike, makineri dhe pajisje, janë lënë për rreth 2-3 vjet e vazhdojnë të jenë në ruajtje në ambiente të hapura në prani të agjentëve atmosferik. Një pjesë e konsiderueshme e tyre në vlerën 152,460,314 lekë, në momentin e dorëzimit kanë qenë në gjendje të mirë teknike (gjendje pune), por si pasojë e keqadministrimit kanë dalë jashtë funksionimit dhe nuk janë në gjendje teknike për tu rivënë në punë. Përveç amortizimit fizik këto automjete, mjete teknologjike dhe makineri, kanë pësuar dhe amortizim moral për shkak të kohës së gjatë në ruajtje.

-Figurojnë gjendje në inventar disa mjete dhe makineri në vlerën 4,590,926 lekë, të cilat kanë dalë jashtë përdorimit gjatë vitit 2011 dhe nuk janë asgjësuar apo shitur për pjesë këmbimi e skrap. Akoma figuron gjendje në inventarë edhe një aparat për karikim baterish me vlerë 320.000 lekë, që është vjedhur para vitit 2012.

-Disa automjete dhe makineri fizikisht ndodhen në ruajtje në shtëpitë e personave përgjegjës, që janë punonjës të institucionit, kjo për arsye se lëvizja e tyre në ambientet e Drejtorisë është e vështirë, pasi transportimi i tyre duhet të bëhet me kamionë vinç dhe kërkon fonde buxhetore shtesë.

- Në fund të vitit 2013 në magazinat e Drejtorisë ndodhet gjendje një sasi e konsiderueshme e materialeve stok në vlerën 58,935,112 lekë, ku pjesën më të madhe të kësaj vlere e zënë pjesët e këmbimit prej 52,061,130 lekë, rezulton se këto pjesë këmbimi i përkasin makinerive dhe mjeteve tashmë të dala jashtë funksioni apo jashtë përdorimit.

Sa më sipër, gjetjet e konstatuara të pasqyruara sipas pikave 6, 7,8 dhe 9, janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me paragrafët 26 deri 30, kapitulli III “Regjistrimi i aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafët 73 deri në 79, kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandime: **9.1.** DRQ Tiranë të marrë masa që të ndiqen procedurat ligjore, të bashkëpunohet me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar, për ngritjen e komisioneve me specialistë të fushës për të vlerësuar gjendjen teknike të automjeteve, mjeteve teknologjike, makinerive teknike dhe pajisjeve, duke propozuar rrugët ligjore që duhen ndjekur, sipas vlerës së përcaktuar nga grupi i punës me ekspertë të fushës përkatëse.

9.2. DRQ Tiranë dhe ARrSh të marrin masa që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore me ankande publike, për shitjen e automjeteve, mjeteve teknologjike, makinerive teknike e pajisjeve, që janë në gjendje pune dhe atyre që për momentin nuk funksionojnë për shkak të qëndrimit të gjatë në ambientet e jashtme, apo të shikohen mundësitë për transferime kapitale për nevoja të njëjësive të tjera publike.

9.3. DRQ Tiranë në bashkëpunim me ARrSh të marrin masa që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e shkallës së përdorimit dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të automjeteve,

mjeteve teknologjike, makinerive teknike dhe pajisjeve, që nuk janë në gjendje pune dhe nuk mund të rikthehen në gjendje pune.

9.4. DRQ Tiranë në bashkëpunim me ARRSH të marrin masa që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për asgjësimin e automjeteve, mjeteve teknologjike, makinerive dhe pajisjeve, që janë jashtë përdorimi, si dhe ato që do të rezultojnë jashtë përdorimi, të përcaktuara nga grupet e specialistëve.

9.5. DRQ Tiranë të marrë masa që të ndiqen të gjitha procedurat e ligjore për shitjen me ankand të materialit skrap, që do të dalë nga asgjësimi i automjeteve, mjeteve teknologjike, makinerive dhe pajisjeve që janë jashtë përdorimit.

9.6. DRQ Tiranë të marrë masa që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shitjen me ankand të pjesëve të këmbimit të makinerive dhe mjeteve që kanë dalë jashtë përdorimit dhe qëndrojnë stok në magazina.

Brenda datës 31.03.2015

10. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë gjatë periudhës prill-maj 2013, ka zhvilluar dhe realizuar 8 procedura prokurimi me fond limit në vlerën **550,473,479 lekë**, për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor për një afat dy vjeçar, nga ku ka rezultuar se:

-Për të **8** kontratat nuk ka projekt zbatimi dhe në dokumentacionin teknik shoqërues nuk ka inventar të rrugëve, duke përfshirë të gjitha detajet.

-Një përshkrim teknik sipërfaqësor është marrë i mirëqenë si specifikime teknike dhe si termat e referencave të rrugëve që do të mirëmbahen dhe janë hartuar njësoj për të 8 kontratat, pa marrë parasysh karakteristikat konstruktive, teknike dhe funksionale të rrugëve të kategorizuar dhe të klasifikuar sipas Kodit Rrugor dhe specifikimeve të Manualit Shqiptar të Rrugëve.

-Volumet e zërave të preventivit nuk kanë dalë dhe nuk janë përcaktuar sipas të dhënave të projektit të rrugës, nuk janë preventivuar shërbimet apo punimet që do të kryhen bazuar në inventarin e rrugës dhe sipas sasive reale apo bazuar në matjet faktike.

-Volumet e zërave të preventivit të mirëmbajtjes me performancë, janë përcaktuar për 1 km rrugë në muaj, duke e shumëzuar për gjithë gjatësinë e rrugës dhe nuk janë marrë parasysh për të zbritur nga preventivi, shërbimet apo punimet që dublohen paralelisht nga mirëmbajtja rutinë, dimërore dhe ajo periodike.

-Për të këto procedura prokurimi në llogaritjen e vlerës limit të kontratave, nuk janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, pasi janë marrë për bazë çmimet e disa kontratave të mirëmbajtjes rrugore të realizuara nga Banka Botërore, por çmimet e referuara nga Banka Botërore janë të viteve para 2007(të vitit 2006 apo 2005), pra gati 6-7 vjet më parë, kohë që akoma nuk kishin dalë manualet teknike të çmimeve.

-Nuk u paraqitën dokumente dhe analiza teknike të çmimeve për të treguar se si janë llogaritur dhe çfarë zërash përfshihen në ndërtimin e tyre. Çmimet e Bankës Botërore mbështeten në kontratat "FIDIC" të financuara nga vetë ajo dhe ato përfshijnë shumë zëra të tjerë nga sa përfshihen në çmimet e përcaktuara në manualin teknik për financimet buxhetore. Kjo mënyrë llogaritje të vlerave të kontratave lejon hapësira për rritje fiktive të tyre.

-Pjesën më të madhe të zërave dhe vlerave të preventivave e zënë zërat e punëve dhe jo zërat e shërbimeve, por kontratat janë prokuruar si kontrata shërbimi dhe dokumentet e tenderit janë hartuar po për kontrata shërbimi, çka ka bërë që për përmbushjen e kritereve të veçanta, shumë operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur dokumente për kontrata shërbimi, por për kontrata për punë.

- Në dy procedura prokurimi, dy operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur sqarime për të argumentuar çmimet e ofertave anomalish të ultë në krahasim me operatorët fitues, por kanë paraqitur ofertat e tyre në tenderë të tjerë, preventivat e të cilëve kanë po të njëjtat çmime për njësi për të njëjtët zëra (zërat e preventivave janë të njëjta për të 8 kontratat), prandaj KVO duhet të merrte të mirëqenë argumentimin e çmimeve të sjellë për tenderët e tjerë dhe ti shpallte fitues këto operatorë, për rrjedhojë do të kishim kursim të fondeve në vlerën **12,594,000 lekë**, nga diferenca ndërmjet vlerës së ofertës së operatorit fitues me ofertën e

operatorit të s`kualifikuar si pasojë e mosparaqitjes së sqarimeve për çmimet. Në këto kushte KVO duhet të kërkonte konfiskimin e 2% të garancisë së ofertës(tenderit) operatorëve ekonomik të shkualifikuar “ N..J “ sh.p.k dhe “A...IMPEX” sh.p.k dhe ta kthente në buxhetin e shtetit, që për të dy tenderët është në vlerën **1,996,490** lekë.

Rekomandime: **10.1.** DRQ Tiranë të marrë masa për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen për shërbimet e mirëmbajtjes së rrugëve, të hartojë specifikimet teknike dhe termat e referencave të rrugëve, duke marrë parasysh karakteristikat konstruktive, teknike e funksionale të rrugëve të kategorizuara e klasifikuara sipas Kodit Rrugor dhe specifikimeve të Manualit Shqiptar të Rrugëve.

10.2. DRQ Tiranë të marrë masa për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen për shërbimet e mirëmbajtjes së rrugëve, hartimi i preventivëve sipas volumeve të punës dhe llogaritja e fondit limit, të përcaktohet sipas të dhënave të projektit të rrugëve, duke u bazuar në inventarin e rrugës dhe në matjet faktike.

10.3. DRQ Tiranë të marrë masa që gjatë hartimit të preventivit, disa zëra për shërbime apo punime të kryhen rakordimet e nevojshme dhe të mos dublohen paralelisht nga mirëmbajtja rutine, mirëmbajtja dimërore dhe mirëmbajtja periodike.

10.4. DRQ Tiranë të marrë masa që në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratave të shërbimit dhe të mirëmbajtjes, të bazohet në manualet teknike të çmimeve për ato zëra që janë përfshirë në të dhe në çmimet e tregut apo të kontratave të mëparshme të realizuara nga ARSH, bazuar në analizat teknike të çmimeve.

10.5. DRQ Tiranë të marrë masa që në hartimin e dokumenteve të tenderit, të konsiderohen kontrata pune dhe jo kontrata shërbimi, të gjitha ato kontrata që vlerën më të madhe të zërave të preventivit e zënë zërat e punëve me çmim/njësi dhe jo zërat e shërbimeve.

Brenda datës 31.03.2015 e në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Nuk ka patur një korrespondencë të rregullt bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktor, mbikëqyrësit të punimeve dhe operatorëve ekonomik, në zbatimin e kontratave të shërbimit, veprim në kundërshtim me pikën 14, të Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që gjatë zbatimit të kontratave, të kryejë e të administrojë në dosje korrespondencën e vazhdueshme me mbikëqyrësin dhe Kontraktorët, duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Urdhër pagesat për situacionet e paraqitura nga operatorët, në shumë raste nuk janë shoqëruar me dokumente që të sigurojnë arritjen e *nivelet të cilësisë së kërkuar të shërbimit*, veprim në kundërshtim me pikën A.2.1, të Specifikimeve Teknike dhe me kërkesat e kontratës.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në asnjë rast të mos lejojë që të kryhen pagesa për situacionet e paraqitura nga operatorët, pa u siguruar se është arritur niveli i kërkuar i cilësisë së shërbimit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Gjatë kontrollit që ka ushtruar Autoriteti Kontraktor lidhur me zbatimin e kontratave, është konstatuar se në disa raste nga Kontraktorët nuk janë respektuar detyrimet sipas kontratës, por nuk është vepruar për të zbatuar penalizmin duke përdorur metodën e “Pikëve të dënimeve”, sipas përcaktimit në pikën A.5.1, të Specifikimeve Teknike.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në çdo rast të konstatimit të mosplotësimit të detyrimeve nga Kontraktori, të zbatojë kriterin e “pikëve të dënimit”, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Nga Kontraktori i shërbimeve nuk janë dorëzuar *raportet e inspektimit të punimeve një herë në dy javë (një të hënë po e një jo)*, sipas përcaktimeve në kontratat dhe Specifikimet Teknike, paragrafi i VIII, në kapitullin A. 3 Inspektimet dhe Provat si dhe A. 8 Detyrat Administrative të Kontraktorit.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që Kontraktorët të dorëzojnë një herë në dy javë raportet e inspektimit të punimeve, sipas kërkesave të përcaktuara në Specifikimet Teknike dhe në zbatim të detyrave kontraktuale.

Në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi : Nga Kontraktori i shërbimeve nuk është krijuar *Njësia e Vetë-Kontrollit* për çdo kontratë, duke mos plotësuar kërkesat e kapitullit A.3, paragrafi i katërt i kushteve të kontratës.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa detyruese për të gjithë Kontraktorët që të krijojnë *Njësitë e Vetë-Kontrollit*, veprimtaria e të cilëve do të përmirësojë nivelin e cilësisë së kërkuar të shërbimeve.

Në vijimësi

16. Gjetja nga auditimi: Për **8 raste** të zbatimit të kontratave të shërbimit e mirëmbajtjes me performancë nuk është e argumentuar pagesa me volume pune e çmime/njësi për 3% e çmimit të kontratës për pagesat me ditë pune, pasi ofertat nuk janë paraqitur me çmime/njësi (lista nr. 8), në mospërputhje me kushtet e kontratës dhe me kërkesat e specifikimeve teknik, për rrjedhojë është krijuar një diferencë në vlerën **5,376,430 lekë**, e cila në kushtet e mosparaqitjes së ofertës me çmime/njësi (lista nr. 8), nuk mund të përdoret për zbatimin e mëtejshëm të kontratave.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor(DRQ Tiranë) në bashkëpunim me kontraktorët përkatës, të marrë masa që të ndjekë procedurat ligjore për negociimin e zërave me çmime/njësi(lista nr. 8), për të bërë të mundur përdorimin e diferencës së krijuar prej **5,376,430 lekë**, që i përket 3 % të vlerës së kontratave (pjesa e mbetur për periudhën korrik 2014 deri në përfundimin e kontratës) dhe përdorimi i kësaj vlere do të konsiderohet i justifikuar, kur përdoret për mirëmbajtjen e rrugëve për rastet e situatave të rënduara nga kushtet atmosferike, në të kundërt të zbritet nga vlera totale e kontratave , në vlerën **5,376,430 lekë**, si më poshtë:

-Operatorit “A..K” sh.p.k. në vlerën **705,751 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi(Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 1, gjithsej 108.2 km” Tiranë.

-Operatorit “A...Asfalt” sh.p.k. në vlerën **182,244 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi(Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 2, gjithsej 103.3 km” Tiranë.

-Operatorit “N..J ” sh.p.k. në vlerën **587,887 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi(Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 4, gjithsej 72.25 km” Tiranë.

-Operatorit “N..A” sh.p.k. në vlerën **434,013 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi(Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 3, gjithsej 82.1 km” Tiranë.

-Operatorit “GJ...A Konstruksion” sh.p.k. në vlerën **568,308 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi (Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 4, gjithsej 72.1 km” Tiranë.

-Operatorit “A...IMPEX & G... Construction” sh.p.k. në vlerën **906,757 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi(Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 7, gjithsej 97.95 km” Tiranë.

-Operatorit “A... IMPEX General Construction” sh.p.k. në vlerën **1,286,170 lekë** me TVSh, për mos argumentimin e pagesës me volume pune e çmime/njësi (Lista nr. 8), në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 8, gjithsej 117.48 km” Tiranë.

-Operatorit “A..K & M... ” sh.p.k. në vlerën **705,300 lekë** me TVSh, për mos argumentim të pagesës me volume pune e çmime/njësi (Lista nr. 8), gjithashtu Autoriteti Kontraktor të rikontrollojë e të bëjë rivlerësim, për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë për periudhën nga muaji korrik 2014 e në vazhdim dhe për realizimin e zërit

C.1(Shtresë asfaltbetoni $t=4$ cm), i situacionuar në muajin qershor 2014 në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 3, gjithsej 87.5 km” Tiranë dhe në bazë të rezultatit të matjeve, të përcaktojë masën e zhdëmtimit.

Brenda datës 31.03.2015

17. Gjetja nga auditimi: Për 5 raste të zbatimit të kontratave të shërbimit e mirëmbajtjes me performancë (seksioni A “Mirëmbajtje Rutinë”), nuk është arritur niveli i sasisë dhe cilësisë së shërbimit, në mospërputhje me kushtet e kontratës dhe me kërkesat e specifikimeve teknike, për rrjedhojë është krijuar një diferencë në vlerën **6,230,450 lekë**, e cila nuk mund të përdoret për zbatimin e mëtejshëm të kontratave.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor(DRQ Tiranë) të marrë masa që të zbresë nga vlera totale e kontratave shumë **6,230,450 lekë**, që i përket shërbimeve të përealizuara, pasi këto shërbime nuk mund të kryhen në periudhë pasardhëse, për shkak se janë me kohë-zgjatje mujore dhe të vijueshme, si më poshtë:

-Operatorit “A..K” sh.p.k. në vlerën **3,094,085 lekë** me TVSh, për mosrealizim të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë, në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 1, gjithsej 108.2 km”, Tiranë.

-Operatorit “N..A” sh.p.k. në vlerën **979,459 lekë** me TVSh, për mosrealizim të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë, në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 5, gjithsej 82.1 km”, Tiranë.

-Operatorit “Gj..Konstruktion” sh.p.k. në vlerën **533,055 lekë** me TVSh, për mosrealizim të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë, në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 6, gjithsej 72.1 km”, Tiranë.

-Operatorit “A...IMPEX & G...Construction” sh.p.k. në vlerën **502,760 lekë** me TVSh, për mosrealizim të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë, në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 7, gjithsej 97.95 km”, Tiranë.

-Operatorit “A... IMPEX General Construction” sh.p.k. në vlerën **1,121,091 lekë** me TVSh, për mosrealizim të shërbimeve të mirëmbajtjes me performancë, në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 8, gjithsej 117.48 km”, Tiranë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105- 109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjor, administrativ e përmbarimorë, në vlerën **13,778,402 lekë**, si më poshtë:

19. Gjetja nga auditimi: Janë kryer pagesa të tepërta, në vlerën **13,778,402 lekë**, për situacionimin e punimeve të pa kryera duke paguar zëra shërbimi/pune të përealizuara, zëra këto të cilët nuk kanë vërtetësi dhe saktësi gjatë pasqyrimin në librezën e masave, aktet e kontrollit dhe ditarin e punimeve. Si rrjedhojë, janë të përfituara nga **16 subjekte** si më poshtë:

-Operatori “N..A” sh.p.k. në vlerën **483,225 lekë** pa TVSh, për diferenca punimesh të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht, në objektin “Riparimi i shtresave asfaltike, segmenti rrugor Ura e Çamëve – Superstrada Peqin”, Qarku Tiranë, në kundërshtim me kontratën e lidhur midis palëve.

-Operatori “N..A” sh.p.k. në vlerën **477,181 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë aksi rrugor Trau Dajt – Teleferiku Dajt”, me gjatësi $L=10$ km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 107, datë 02.05.2011, të lidhur midis palëve.

-Operatori “ *N..A*” sh.p.k. në vlerën **163,152 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë aksi rrugor Tirane – K/Dajt – Kamp + K/Dajt – Bizë + K/Dajt - Antena”, me gjatësi L=62km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 224, datë 07.12.2011, të lidhur midis palëve.

-Operatori “ *L..I- BL*” sh.p.k. në vlerën **915,142 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performacë, segmenti rrugorë Xibrakë –Qafëthanë, 51 km” Qarku Elbasan, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 162, datë 18.12.2012, të lidhur midis palëve.

-Operatori “ *D..A*” sh.p.k. në vlerën **571,713 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performacë, segmenti rrugorë Librazhd-Steblevë, 32 km”, Qarku Elbasan, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 163, datë 18.12.2012, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*A..K M...*” sh.p.k. në vlerën **1,337,069 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performacë, segmenti rrugorë K/Dajt-Bizë-Q/Priskë-Shëngjergj, 76 km”, Qarku Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 159, datë 18.12.2012, të lidhur midis palëve.

-Operatori “ *Vëllezërit H..A*” sh.p.k. në vlerën **428,785 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performacë, segmenti rrugorë Elbasan-Gjinar, 24 km”, Qarku Elbasan, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 161, datë 18.12.2012, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*N..A*” sh.p.k. në vlerën **342,899 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performacë, segmenti rrugorë Tiranë (Kaçolitë, km 29)-Elbasan, 19 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 160, datë 18.12.2012, të lidhur midis palëve.

-Operatori “ *SH..A-M*” sh.p.k. në vlerën **397,042 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performacë, segmenti rrugorë Tiranë-K/Dajt-Antena, 22 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 158, datë 18.12.2012, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*A..K*” sh.p.k. në vlerën **884,977 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 1, gjithsej 108.2 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 229, datë 30.05.2013, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*N..A*” sh.p.k. në vlerën **3,790,435 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 5, gjithsej 82.1 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 226, datë 30.05.2013, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*GJ..Konstruksion*” sh.p.k. në vlerën **2,330,948 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 6, gjithsej 72.1 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 223, datë 30.05.2013, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*A... IMPEX & G... Construction*” sh.p.k. në vlerën **498,773 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 7, gjithsej 97.95 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 217, datë 28.05.2013, të lidhur midis palëve.

-Operatori “*A... IMPEX & G...Construction*” sh.p.k. në vlerën **436,080 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 8, gjithsej 117.48 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 218, datë 28.05.2013, të lidhur midis palëve.

-Operatori “ *N..J*” sh.p.k. në vlerën **189,068 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 4, gjithsej 72.25 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës datë 27.05.2013, të lidhur midis palëve.

-Operatori “A..K M...” sh.p.k. në vlerën **531,913 lekë** pa TVSH, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 3, gjithsej 87.5 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 213, datë 27.05.2013, të lidhur midis palëve.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që të kontabilizohet detyrimi prej **13,778,402 lekë** dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm administrativë dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

-Operatorit “N..A” sh.p.k. në vlerën **483,225 lekë** pa TVSh, për diferenca punimesh të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Riparimi i shtresave asfaltike, segmenti rrugor Ura e Çamëve – Superstrada Peqin”, Tiranë.

-Operatorit “N..A” sh.p.k. në vlerën **477,181 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë aksi rrugor Trau Dajt – Teleferiku Dajt”, me gjatësi L=10km”, Tiranë.

-Operatorit “N..A” sh.p.k. në vlerën **163,152 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë aksi rrugor Tirane – K/ Dajt – Kamp + K/Dajt – Bizë + K/Dajt - Antena”, me gjatësi L=62km”, Tiranë.

-Operatorit “L..I- BL” sh.p.k. në vlerën **915,142 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Xibrakë –Qafëthan, 51 km”, Tiranë.

-Operatorit “D..A” sh.p.k. në vlerën **571,713 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Librazhd-Steblev, 32 km”, Tiranë.

-Operatorit “A..K ...” sh.p.k. në vlerën **1,337,069 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor K/Dajt-Bizë-Q/Prisk-Shëngjergj, 76 km”, Tiranë.

-Operatorit “Vëllezërit H...” sh.p.k. në vlerën **428,785 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Elbasan-Gjinar, 24 km”, Tiranë.

-Operatorit “Nika” sh.p.k. në vlerën **342,899 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Tiranë(Kaçulitë, km 29)-Elbasan, 19 km”, Tiranë, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 160, datë 18.12.2012.

-Operatorit “Shqiponja-M” sh.p.k. në vlerën **397,042 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Tiranë-K/Dajt-Antena, 22 km”, Tiranë.

-Operatorit “A..K” sh.p.k. në vlerën **884,977 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryera dhe të përfituar padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 1, gjithsej 108.2 km”, Tiranë.

-Operatorit “N..A” sh.p.k. në vlerën **3,790,435 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 5, gjithsej 82.1 km”, Tiranë.

-Operatorit “GJ...Konstruksion” sh.p.k. në vlerën **2,330,948 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 6, gjithsej 72.1 km”, Tiranë.

-Operatorit “A... IMPEX G... Construction” sh.p.k. në vlerën **498,773 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 7, gjithsej 97.95 km”, Tiranë.

-Operatorit “A... IMPEX G... Construction” sh.p.k. në vlerën **436,080 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/pune të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 8, gjithsej 117.48 km”, Tiranë.

-Operatori "N..J" sh.p.k. në vlerën **189,068 lekë** pa TVSh, për punë të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 4, gjithsej 72.25 km", Tiranë.

-Operatorit "A..K Munella" sh.p.k. në vlerën **531,913 lekë** pa TVSh, për zëra shërbimi/punë të pa kryer dhe të përfituara padrejtësisht në objektin "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 3, gjithsej 87.5 km", Tiranë.

Brenda datës 31.03.2015

C. MASA DISIPLINORE

C.I. Mbështetur në nenin 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.0.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", nenin 37 dhe 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në nenin 10, të "Kontratës individuale të punës", i rekomandojmë Drejtorit të Rajonit Qendror Rrugor Tiranë, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Zgjidhje të kontratës së punës" për:

1. Z. N.P. me detyrë specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, i licencuar (licencë nr. MK 0070/2), i cili me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë, është ngarkuar me detyrë për mbikëqyrjen e zbatimit të 4 kontratave të shërbimit me afat 18.12.2012 deri 17.05.2013, për objektet: "Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Xibrak-Qafëthanë, 51 km", "Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Librazhd-Steblev, 32 km", "Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Tiranë-K/Dajt-Antena, 22 km", "Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Tiranë(Kaçolitë, km 29)-Elbasan, 9 km" dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të 5 kontratave të shërbimit me afat 24 muaj, për objektet: "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 1, gjithsej 108.2 km" "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 5, gjithsej gjithsej 82.1 km", "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 6, gjithsej 72.1 km", "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 7, gjithsej 97.95 km", "Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 8, gjithsej 117.48 km", për shkak se:

a- Kontratat e shërbimit nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, gjithashtu nuk është i plotë dokumentacioni vlerësues që përcakton nivelin e sasisë dhe cilësisë së realizuar për zërat e shërbimit, për rrjedhojë nuk janë përcaktuar me saktësi shërbimet e kryera sipas zërave. Si rezultat i situacionimit të zërave të pa kryer, që i përkasin mirëmbajtjes rutinë, mirëmbajtjes dimërore dhe situacionimi i vlerës 3% të kontratës, duke mos e argumentuar me volume pune të kryera, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga **9** operatorë ekonomik të kontraktuar, sipas gjetjeve të auditimit me numër rendor 11, 2, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

b- Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës së hartimit të specifikimeve teknike, termave të referencës, preventivave të zbatimit dhe llogaritjes së vlerave të 8 kontratave të mirëmbajtjes dhe me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e rregullave të prokurimit publik, si më poshtë:

-Për të tetë kontratat nuk ka dokumentacionin teknik shoqëruar, nuk ka inventar të rrugëve dhe nuk janë marrë parasysh karakteristikat konstruktive, teknike dhe funksionale të rrugëve të kategorizuar dhe të klasifikuar sipas Kodit Rrugor dhe specifikimeve të Manualit Shqiptar të Rrugëve.

-Volumet e preventivit nuk kanë dalë dhe nuk janë përcaktuar sipas projektit të zbatimit, nuk janë preventivuar shërbimet apo punimet që do të kryhen bazuar në inventarin e rrugës dhe sasive faktike dhe reale apo bazuar në matjet faktike dhe nuk janë marrë parasysh për ti

zbritur nga preventivi disa shërbime apo punime që dublohen paralelisht nga mirëmbajtja rutine, dimërore dhe ajo periodike.

-Për të tetë procedurat e prokurimit për llogaritjen e vlerës limit të kontratave, nuk janë zbatuar kërkesat që janë përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, pasi janë marrë për bazë çmimet e disa kontratave të mirëmbajtjes rrugore të realizuara nga Banka Botërore dhe nuk u paraqitën dokumente dhe analiza teknike të çmimeve, se si janë llogaritur dhe çfarë zërash përfshihen në ndërtimin e tyre , për rrjedhojë kjo mënyrë llogaritje të vlerave të kontratave lejon hapësira për rritje fiktive të vlerave të tyre.

- Kontratat janë prokuruar si kontrata shërbimi dhe dokumentet e tenderit janë hartuar po për kontrata shërbimi dhe nuk janë ndarë si të veçanta, kontrata për punë dhe në kontrata shërbimi, pasi pjesën më të madhe të zërave dhe vlerave të preventivave, e zënë zërat e punëve dhe jo zërat e shërbimeve, çka ka bërë që për përmbushjen e kriterëve të veçanta shumë operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur dokumente për kontrata shërbimi por kontrata për punë.

Sa më sipër vepruar në kundërshtim me kontratat e hartuara, nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, pikat 3.2 e 3.3, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.0.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”.

C.II. Mbështetur në nenin 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.0.2007“Për Rregullat e Prokurimit Publik” nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në nenin 10, të “Kontratën individuale të Punës”, i rekomandojmë Drejtorit të Rajonit Qendror Rrugor Tiranë, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 6 punonjës, si më poshtë:

1. z. Xh.M. ish-specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, aktualisht me detyrë specialist në Drejtorinë e Rajonit Rrugor Gjirokastër, i licencuar(licencë nr. MK 0743), i cili me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Rajonit Qendror Tiranë, është ngarkuar me detyrë për mbikëqyrjen e zbatimit të 2 (dy) kontratave të shërbimit me afat 18.12.2012 deri 17.05.2013(5 muaj), për objektet: “*Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugorë K/Dajt-Bizë-Q/Priskë-Shëngjergj, 76 km*”, “*Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Elbasan-Gjinarë, 24 km*” dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të një kontrate shërbimi me afat 24 muaj, për objektin “*Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 3, gjithsej 87.5 km*”, për shkak se:

- Kontratat e shërbimit nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, gjithashtu nuk është i plotë dokumentacioni vlerësues që përcakton nivelin e sasisë dhe cilësisë së realizuar për zërat e shërbimit, duke mos pasqyruar me saktësi punimet e kryera. Si rezultat i situacionimit të zërave të pa kryer, që i përkasin mirëmbajtjes rutinë, mirëmbajtjes dimërore dhe situacionimi i vlerës 3% të kontratës, duke mos e argumentuar me volume pune të kryera, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga 3 operatorë ekonomik të kontraktuar, sipas gjetjeve të auditimit me numër rendor 11, 2, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Sa më sipër vepruar në kundërshtim me kontratat e hartuara, nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, pikat 3.2 e 3.3, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011.

-Masa disiplinore që është rekomanduar për z. **XH.M.**duhet ti njoftohet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Drejtorisë së Rajonit Rrugor Gjirokastër, pasi që nga muaji Qershor 2014 e në vazhdim është punonjës i DRRr Gjirokastër.

2. z. A.S. Specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës së hartimit të specifikimeve teknike, termave të referencës, preventivave të zbatimit dhe llogaritjes së vlerave të 8 kontratave të mirëmbajtjes.

3. z. E.K. Specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës së hartimit të specifikimeve teknike, termave të referencës, preventivave të zbatimit dhe llogaritjes së vlerave të 8 kontratave të mirëmbajtjes.

Për këta dy punonjës kërkohet kjo masë disiplinore sepse në auditimin e 8 procedurave të prokurimit për mirëmbajtjen e rrugëve për një afat dy vjeçar me fond limit në vlerën 550,473,479 lekë të realizuara gjatë periudhës prill-maj 2013, kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik , si më poshtë:

Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës së hartimit të specifikimeve teknike, termave të referencës, preventivave të zbatimit dhe llogaritjes së vlerave të 8 kontratave të mirëmbajtjes dhe me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e rregullave të prokurimit publik , si më poshtë:

-Për të tetë kontratat nuk ka dokumentacionin teknik shoqëruar, nuk ka inventar të rrugëve dhe nuk janë marrë parasysh karakteristikat konstruktive, teknike dhe funksionale të rrugëve të kategorizuara dhe të klasifikuar sipas Kodit Rrugor dhe specifikimeve të Manualit Shqiptar të Rrugëve.

-Volumet e preventivit nuk kanë dalë dhe nuk janë përcaktuar sipas projektit të zbatimit, nuk janë preventivuar shërbimet apo punimet që do të kryhen bazuar në inventarin e rrugës dhe sasive faktike dhe reale apo bazuar në matjet faktike dhe nuk janë marrë parasysh për ti zbritur nga preventivi disa shërbime apo punime që dublohen paralelisht nga mirëmbajtja rutine, dimërore dhe ajo periodike.

-Për të tetë procedurat e prokurimit për llogaritjen e vlerës limit të kontratave, nuk janë zbatuar kërkesat që janë përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, pasi janë marrë për bazë çmimet e disa kontratave të mirëmbajtjes rrugore të realizuara nga Banka Botërore dhe nuk u paraqitën dokumente dhe analiza teknike të çmimeve, se si janë llogaritur dhe çfarë zërash përfshihen në ndërtimin e tyre , për rrjedhojë kjo mënyrë llogaritje të vlerave të kontratave lejon hapësira për rritje fiktive të tyre.

-Kontratat janë prokuruar si kontrata shërbimi dhe dokumentet e tenderit janë hartuar po për kontrata shërbimi dhe nuk janë ndarë si të veçanta, kontrata për punë dhe në kontrata shërbimi, pasi pjesa më e madhe e zërave dhe vlerave të preventivave, e zënë zërat e punëve dhe jo zërat e shërbimeve, çka ka bërë që për përmbushjen e kritereve të veçanta shumë operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur dokumente për kontrata shërbimi por kontrata për punë.

- Në dy procedura prokurimi, dy operatorë ekonomik nuk kanë paraqitur sqarime për të argumentuar çmimet e ofertave anomalish të ultë në krahasim me operatorët fitues, por kanë paraqitur ofertat e tyre në tenderë të tjerë, preventivat e të cilëve kanë po të njëjtat çmime për njësi për të njëjtët zëra (zërat e preventivave janë të njëjta për të 8 kontratat), prandaj KVO duhet të merrte të mirëqenë argumentimin e çmimeve të sjellë për tenderët e tjerë dhe ti shpallte fitues këto operatorë, për rrjedhojë do të kishim kursim të fondeve. Të paktën, KVO duhet të kërkonte konfiskimin e 2% të garancisë së ofertës (tenderit) operatorëve ekonomik të shkualifikuar “ N..J “ sh.p.k dhe “A.. IMPEX” sh.p.k dhe ta kthente në buxhetin e shtetit, që për të dy tenderët është në vlerën **1,996,490** lekë.

4. z. M.R. Specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, i cili është caktuar Inspektor për zbatimin e kontratës së shërbimit për objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 5, gjithsej 82.1 km”, për periudhën 30.12.2013 deri 29.06.2014.

5. z. S.N. Specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, i cili është caktuar Inspektor për zbatimin e kontratës së shërbimit për objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 6, gjithsej 72.1 km”, për periudhën 30.05.2013 deri 29.03.2014.

6. z. I.R. Specialist në Drejtorinë e Rajonit Qendror Tiranë, i cili është caktuar Inspektor për zbatimin e kontratës së shërbimit për objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 7, gjithsej 97.95 km”, për periudhën 30.05.2013 deri 29.12.2013 dhe për e zbatimin e kontratës së shërbimit për objektin “Mirëmbajtje me performancë, Kontrata nr. 8, gjithsej 97.95 km”, për periudhën 30.05.2013 deri 29.06.2014.

Për këta punonjës të caktuar si Inspektor të kontratës, kërkohet kjo masë disiplinore, për shkak se:

Kontratat e shërbimit nuk janë zbatuar në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike dhe nuk janë arritur nivelet e cilësisë së shërbimit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, gjithashtu nuk është dërguar informacion në vazhdimësi tek Autoriteti Kontraktor, për të bërë prezent problemet e ndryshme që janë konstatuar gjatë zbatimit të kontratave, duke mos përmbushur detyrat e caktuara.

Sa më sipër vepruar në kundërshtim me kontratat e hartuara dhe me kërkesat e Specifikimeve Teknike.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, në pikën 1, të nenit 15, të ligjit 8402, datë 10.09.21998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 20/13, datë 14.02.2013, që për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i kërkojmë **Drejtorit të Rajonit Qendror Rrugor Tiranë**, ti propozojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, i cili ka në juridiksion territorin ku ndodhen objektet e trajtuara sipas kontratave (duke i bashkëlidhur fotokopjen e procesverbalit përkatës që trajton çështjen), që të vendosë sanksionet ligjore sipas shkallës së shkeljeve dhe përgjegjësisë për mbikëqyrësit e punimeve, si më poshtë:

1. Subjekti “A&E...” shpk, përfaqësuar nga ing. E.Ç. (licenca nr. MK 1476/4), me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 89/1 prot. , datë 12.04.2011, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për “Riparimi i shtresave asfaltike, segmenti rrugor Ura e Çamëve – Superstrada Peqin”, për shkak se:

b-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit për tre zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **483,225 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “N...” shpk.

Në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar.

2. Subjekti “M...K Studio” shpk (licenca nr. MK 1811), me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit nr. 107/1 prot, datë 02.05.2011, për mbikëqyrjen e zbatimit të zërave të shërbimit/punë për objektin “Mirëmbajtje me performancë aksi rrugor Trau Dajt – Teleferiku Dajt”, me gjatësi L=10km, për shkak se:

-Zërat e shërbimit/punës nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet e zbatimit dhe librezat e masave e dokumentacioni tjetër vlerësues për përshkrimin e zërave shërbimit/punës të zbatuara, nuk pasqyrojnë me vërtetësi realizimin e tyre për të përcaktuar saktë zërat e shërbimeve/punë të kryera. Si rezultat i situacionimit për tre zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera dhe situacionimi i vlerës 3% të kontratës, duke mos e argumentuar me volume punime të kryera, gjithsej në vlerën **477,181 lekë**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “N...” shpk.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar.

Nga Drejtoria Rajonale Qendror Tiranë (Autoriteti Rrugor Shqiptar), me shkresë nr. 69, prot, datë 20.01.2015, protokolluar në KLSH me nr.741/11 datë 21.01.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Luan Kuka, Bashkim Harizaj, Nefail Xhepexhiu, Abdulla Duka dhe Xhemal Luka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.